

*“Deri sa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”*

SHPRESA NË ALLAHUN

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin **ERIXH LIN-NESHRI**

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli:

SHPRESA NË ALLAHUN

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik, 2009

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

SHPRESA NË ALLAHUN

Gjatë këtij fjalimi tim, desha të jetë kuptimi i imanit të fortë, i cili arrihet nëpërmjet parimit të Allahut se:

“Ai (njeriu) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhrin e All-llahut e ruajnë atë.

All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre. Po, kur All-llahu vendos ta ndëshkojë një popull, atë nuk ka kush që ta zmbrapsë. Ata, (njerëzit) nuk kanë mbrojtës tjetër, pos Tij.”

(Err-Rraëd, 11)

Do të angazhohem për përmirësim dhe ndryshim të gjendjes në të mirë. Do të angazhohem që të asgjësohet pesimizmi dhe të zëvendësohet me shpresë, dhe bindje të plotë në Allahun, Zot të gjithë botëve. Për shkak se sa më shumë që të shtohet shpresa dhe bindja në Allahun e Lartmadhëruar, shtohet shpresa për realizimin e premtimit të Allahut të Lartmadhëruar për ndihmë, forcë, fitore dhe

qeverisje. Për këtë arsye duhet që umeti të jetë i bazuar në shpresën e ardhmërisë më të mirë, në shpresën për fitoren e sigurt dhe qeverisjen e plotë të fesë së Allahut, dhe praktikimit të sheriatit të pastër dhe madhështore.

Lus Allahun e Lartmadhëruar që të me sjell dobi mua nga kjo ligjëratë, po ashtu lus Allahun që ta bëjë rrugë për ta kthyer shpresën dhe optimizmin në zemrat e muslimanëve, dhe angazhim në drejtim të ndryshimeve pozitive, dhe përmirësimin e gjendjes së vështirë e të mjerueshme, e cila momentalisht për fatkeq ekziston dhe që e nesërmja të jetë forcë, fuqi, ndihmë, fitore, dhe udhëheqje e islamit dhe muslimanëve, se vërtetë Allahu është ndihmëtari ynë, Ai ka mundësi për këtë, Ai na mjafton dhe nuk ka ndihmëtarë më të mirë se Ai.

RREZIKU I PESIMIZMIT DHE HUMBJES SË SHPRESËS

Përkundër agresioneve të egra, të cilat edhe sot po vazhdojnë në Palestinë, Bagdad, Afganistan, Çeçeni dhe në vendet Islame..

Përkundër vrasjeve, padrejtësive, frika dhe brengosja, e cila po është e pranishme (prezent) në umetin tonë..

Përkundër asaj se shumica pyesin me habi: A është momenti për të folur për shpresë?!

Përkundër asaj se shumica veç i kanë humbur shpresat dhe thonë: Nuk ka më dobi?!

Përkundër asaj se njerëzit thonë: Këtë që po e thua për Palestinën, Mesxhidi Aksanë është vetëm iluzion. Ne veç jemi lodhur me fjalë, ndërsa në vepër është krejt e kundërta. Nuk ka dobi!

Përkundër të gjitha këtyre vështirësive e krizave, përkundër këtij pesimizmi, e cila ka kapluar këtë umet:

Deklaroj me bindje të thellë dhe me vendosmëri të plotë se:

Tani është koha më e përshtatshme për të diskutuar rreth shpresës. Unë e ndiej obligim për të diskutuar për shpresën dhe optimizmin, për ta mbjellë në

zemrat e muslimanëve rregullin e planprogramit hyjnorë:

“Derisa mos ta ndryshojnë gjendjen e tyre”.

Dëshiroj dhe njëherit angazhohem që ta ndryshoj pikëllimin dhe pesimizmin në shpresë, optimizëm dhe qetësi, edhe përkundër asaj se Palestina, Bagdadi, Afganistani, Çeçenia, dhe vendet tjera islame sulmohen edhe e kësaj dite në mënyrën më të egër.

Edhe përkundër asaj se vrasjet, krimet, frika, brengat dhe terrori ende ushtrohen dhe vazhdojnë ndaj umetit tonë..

Edhe përkundër asaj se shumica pyesin: A tani është koha të flitet për shpresë dhe optimizëm?

Edhe përkundër asaj se shumica e njerëzve thonë: Këtë që po e thua për Palestinën, Mesxhidi Aksanë është vetëm iluzion, pse jemi lodhur me premtime dhe fjalë, ndërsa nuk ka ndryshuar asgjë, pra s’ka më vend për optimizëm.

Edhe përkundër asaj se jemi në krizë, jemi në gjendje të vështirë, dhe pesimizmi e ka kapluar umetin tonë:

Deklaroj me bindje të thellë dhe me vendosmëri të plotë se: Tani është koha më e përshtatshme për të diskutuar rreth shpresës. Unë e ndiej obligim për të diskutuar për shpresën dhe optimizmin, për ta mbjellë në zemrat e muslimanëve rregullin e planprogramit hyjnorë:

“Derisa mos ta ndryshojnë gjendjen e tyre”. Dëshiroj dhe njëherit angazhohem që ta ndryshoj pikëllimin dhe pesimizmin në shpresë, optimizëm dhe qetësi.

Deklaroj me bindje të thellë:

Është obligim të parashtrohet tema “Shpresa dhe optimizmi”, si rregull i planprogramit hyjnorë. Derisa ta ndryshojnë gjendjet e tyre.

Tani është koha e përshtatshme, pse unë po e ndiej se pesimizmi e ka kapluar për së tepërmi umetin tonë, ndërsa pesimizmi është çështje shumë e rrezikshme, dhe është dukuri e pranishme (prezent) ne umetin tonë.

Pesimizmi lëkund besimin ne Allahun e Lartmadhëruar.

Pesimizmi sjell dyshim në besim në kadanë dhe kaderin në zemrat e njerëzve.

Pesimizmi është armik i shpresës dhe suksesit, armik i ndihmës dhe qeverisjes.

Pesimizmi është aleat i dështimit.

Pesimizmi shpie në përtaci, krizë më të thellë dhe neglizhencë.

Pesimizmi ia humb umetit fuqinë, aktivitetin dhe punën. Pesimizmi e humb qëllimin , angazhimin dhe vlerën e umetit.

Pesimizmi ia humb umetit rolin kryesor që e ka, angazhimin dhe ambiciet.

Umeti pesimist dështon në gjithçka.

Umeti pesimist është përtac, i poshtëruar dhe i pavlerë.

Umeti pesimist është i plogësht, asnjë prej pjesëtarëve të tij nuk dëshiron të punoj, asnjë nuk dëshiron të prodhoj, asnjë nuk dëshiron suksese dhe rezultate pozitive.

Umeti pesimist është i gjykuar për t'u shkatërruar.

SHPRESA DHE AMBICIA

Shpresa është fillim i ambicies, jeton me të dhe për të. Shpreson që të realizohet dhe duhet të realizohet. Patjetër duhet të besosh në këtë fjalë. Çdo gjë që e dëshiron për vete duhet ta kesh në mendje për ta realizuar, pastaj jeton me të dhe për të. Patjetër duhet ta realizosh atë që e dëshiron. Kjo është punë e kryer.

Ejani të shpresojmë të gjithë së bashku.

Ejani të shpresojmë të gjithë së bashku se umeti do t'ia arrijë qëllimit për ta çliruar mesxhidi Aksanë.

Tento për të qenë i bindur se do të realizohet çlirimi i Mesxhidi Aksasë. Unë mbjell tek ju shpresën. Ashtu siç ka mbjellë pejgamberi s.a.v.s. tek sahabët r.a., dhe ashtu do të ndodh me caktimin e Zotit të Lartmadhëruar.

Ejani të gjithë të shpresojmë se do të hymë ne Mesxhidi Aksa nëpërmjet derës për të cilën Musa a.s. i ka thënë popullit të tij:

“Hyni për dere të përulur, bini sexhde dhe përshëndetni me fjalë të mirë.”

Ejani të shpresojmë se do ta shohim “Kubën e Sahrasë”.

Ejani të shpresojmë të gjithë së bashku se do t’i shohim trungjet e ullinjëve.

Ejani të shpresojmë të gjithë se do t’i shohim dyert e Mesxhidi Aksasë.

Ejani të shpresojmë të gjithë se do t’i shohim dritaret e Mesxhidi Aksasë.

Ejani të shpresojmë të gjithë se do ta përjetojmë dhe të shohim ku e ka bërë Muhamedi a.s. “Isranë”.

Ejani të shpresojmë të gjithë se do t’i shohim të gjithë myslimanët në Mesxhidi Aksa duke lexuar ajetin kur’anor:

“Dhe thuaj: Erdh (triumfoi) e vërteta dhe humbi (u mposht) e pavërteta. Nuk ka dyshim se e pavërteta është e caktuar për humbje dhe dështim.”

(El-Isra, 81)

Ejani të shpresojmë të gjithë se do t’i shohim myslimanët duke u falë në Mesxhidi Aksa dhe duke rënë në sexhde, aty ku ka rënë në sexhde Muhamedi a.s. në Natën e Israsë.

Ejani të shpresojmë të gjithë se do të jemi në vendin ku ka qenë Salahudin el-Ejubi – Zoti e pastë mëshiruar.

Ejani të shpresojmë të gjithë se do të kthehet udhëheqja e muslimanëve në Irak.

Vëlla!!

Këto shpresa mund të realizohen nëse i kthehemi punës dhe i nënshtrohemi ajetit kur'anor:

“Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata mos ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”

Këto shpresa mund të realizohen nëse të gjithë bëhemi të sinqert dhe korrim sukses në punët tona, nëse korrim sukses në studimet tona, nëse bëhemi pozitiv, nëse sillemi mirë me baballarët dhe nënat tona, nëse bëhemi zhvillues të vendit tonë sinqerisht, punojmë me seriozitet, përpiqemi dhe punojmë pandërprerë.

PËRGËZIMET, PARALAJMËRIMET, DHE NXITJE PËR SHPRESË, DHE BESIM NË ALLAHUN E LARTMADHËRUAR

Do t'i përmendi çështjet dhe udhëzimet që na bëjnë të jemi të bindur se shpresat, dhe ambiciet realizohen, dhe se është domosdoshmëri, realitet dhe e patjetërsueshme.

1. Ligji i Allahut në botë është ekzakt dhe i pandryshuar. E, prej atij ligji është:

“Dhe, këto janë ditët të cilat i ndërrojmë në mes njerëzve.”

(Ali Imran, 140)

Nuk ka dyshim se ditët ndërrohen, koha ndryshon, ndërsa çështjet në to nuk janë gjithmonë të njëjta, dhe nuk shkojnë me të njëjtin ritëm. Udhëheqja në tokë për një kohë të gjatë ka qenë në duart e lindjes, shumica e peygambereve kanë qenë prej lindjes, posaçërisht prej Irakut. Ai është qytet i peygamberit tonë Junus a.s., pastaj udhëheqja ka kaluar në duart të perëndimit, respektivisht tek Grekët e vjetër, pastaj ka kaluar prapë në duart të lindjes, kur u dërgua peygamberi në atë rajon dhe ka zgjatë 1300 vite udhëheqja e lindjes, pastaj prapë ka kaluar në

duar të perëndimit, pra në shekullin e kaluar ka kaluar në duar të perëndimit.

Tani, te kush do të kthehet udhëheqja?
Me dëshirën dhe me lejen e Zotit do të kthehet te lindorët (e lindjes) pra te ne. E, ky është paralajmërim dhe përgëzim.

E, prej atij ligji:

“Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ta ndryshojnë ata gjendjen e tyre.”

(Erraëd, 1)

Po të kthehemi në atë çka Allahu kënaqet me ne, do t'i ndryshonte Allahu çështjet, të cilat do të na i plotësojnë dëshirat dhe do të ishim të kënaqur. Edhe ky është një paralajmërim.

KY UMET NUK ZHDUKET DHE NUK DËSHTON TËRËSISHT ASNJËHERË

Në këtë fe duhet të jetë imani dhe vendosmëria e plotë në të. Ky umet mund të dobësohet, por kurrë nuk zhduket. Patjetër duhet të rikthehet në udhëheqje si superfuqi e pamposhtur. Ky umet nuk është sikur popujt e tjerë, të cilët kanë dështuar dhe kanë humbur, siç është rasti me Persianët, Romakët dhe Faraonët.

Ky umet do të vazhdoj gjithmonë, sepse e ka për barrë mbajtjen e fjalës se fundit prej Allahut në fytyrën e tokës, Kur'anin fisnik, sikurse e ka për barrë po ashtu mbajtjen e fjalës së fundit prej Allahut, i cili e ka garantuar nëpërmjet ajetit kur'anor:

“Nuk ka dyshim se ne e kemi dhënë, e kemi zbritur këtë këshillë (kur'an, fe, ligj) dhe nuk ka dyshim se atë e ruajmë.”

(El-Hixhr, 9)

Nëse ky umet zhduket, atëherë duhet të ndodh Dita e Kijametit. Nëse ky umet zhduket, kush e merr rolin e besimit në një Zot në fytyrën e tokës? Nëse ky umet zhduket, kush e merr përsipër vendosjen e ligjit të Allahut (sheriatin) në fytyrën e tokës?

Ky umet është sikurse dielli, sikurse hëna.

Nëse ky umet zhduket ndodh Dita e Kijametit.

Ne sot jemi vetëm nxënia e diellit me hënë, e jo perëndim i diellit.

Vërtetë, kur të ndodh nxënia e diellit me hënë, e kthehen në strofujt e tyre dhe qëndrojnë aty duke pritur ndriçimin e diellit, dhe largimin e hënës, sepse ato e dinë se dielli nuk është duke humbur në tërësi, nuk është duke përfunduar.

Njësoj edhe ky umet, në epokën që kaloi ishte sikurse nxënia e diellit me hënë, e jo perëndim i tij.

Zogjtë e presin diellin, sepse nuk ka dritë të mjaftueshme, e cila është e nxënë prej diellit.

Ky umet është i sigurt se ka ardhur koha që të humbet errësira dhe përhapet e të shndrisë dritë, prej dritës së rinisë islame e përmbajtur me fe.

Ky umet nuk zhduket, ky është paralajmërim për ne.

AJETET KUR'ANORE DHE HADITHET E MUHAMEDIT A.S.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Vërtet Ne u ndihmojmë të dërguarve tanë, dhe atyre që besojnë në këtë botë, dhe poashtu ditën e kiametit kur do të sillen dëshmitarët.”

(Gafir, 51)

Fitorja nuk është vetëm e pejgamberit, por edhe e besimtarëve. Por, bëhet pyetja: Kur? Përgjigja është: Në këtë botë dhe botën tjetër.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“E ka shkruar dhe e ka caktuar Allahu: Unë dhe të dërguarit e mi do të triumfojnë.”

(El-Muxhadele, 21)

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Allahu u ka premtuar disave prej jush, që kanë besuar dhe që punojnë vepra të mira, se do t'i bëjë udhëheqës dhe prijës në fytyrën e tokës ashtu siç i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcoj fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur, dhe që do t'ua shndërroj atyre – pas frikës, sigurinë. Ata me adhurojnë Mua, e nuk më bëjnë shok e as rival askënd.”

(En-Nur, 55)

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dëshirojnë që me gojë të tyre ta fikin dritën e Allahut, por Allahu është i fuqishëm në përsosshmërinë e dritës së Tij, edhe pse nuk e dëshirojnë dhe e urrejnë pabesimtarët.”

(Es-Saf, 8)

Kur në të njëjtën kohë paraqitet dëshira e njeriut dhe dëshira e Allahut. Dëshira e kujt realizohet?

Për dëshirën e Tij, Zoti thotë:

“Allahu është triumfues në çështjet e Tij, mirëpo këtë shumica e njerëzve nuk e dinë.”

(Jusuf, 21)

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“(Allahu) Është Ai, i cili ka dërguar të dërguarin e Tij dhe fenë e vërtetë për të triumfuar mbi të gjitha fetë, edhe pse këtë nuk e dëshirojnë dhe e urrejnë idhujtarët.”

(Et-Tevbe, 33)

Ku mund të shkojmë me këto premtime?

Ejani pra të mbjellim shpresën dhe optimizmin në zemrat tona!

Përpos premtimeve dhe paralajmërimeve të Kur'anit të shpërmendura, tani do t'i përkujtojmë disa premtime dhe paralajmërime pejgamberike.

Temim ed-Dari transmeton se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:

“Do të kuptohet dhe do të sqarohet kjo çështje ashtu siç qartësohet dita prej natës. Allahu i Lartmadhëruar nuk do të lejojë asnjë shtëpi pa e depërtuar fenë e Tij, për t'i lartësuar me lartësinë e Tij, ose kush nuk e pranon, për t'i poshtëruar, për shkak të refuzimit dhe të mospranimit.” Pastaj tregon Temimi se këtë e kam kuptuar kur ka ndodhur në familjen time: Kush e ka pranuar islamin është ngritur, është lartësuar, dhe i kanë ardhur të gjitha të mirat, ndërsa ata të cilët nuk e kanë pranuar islamin, por kanë qëndrua në pabesimin e tyre, i ka kapluar poshtërimi, ulja dhe xhizja.

(Musnedi i Imam Ahmedit, 16344)

Transmeton Thuban se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Vërtet Allahu ma ka paraqitur tokën, ku kam parë lindjen dhe perëndimin dhe umeti im do ta udhëheq lindjen dhe perëndimin, dhe gjithçka mes tyre. Më janë dhënë dy thesaret: të kuqëve dhe të bardhëve. Pastaj e kam lutur Zotin tim për umetin tim, që mos t'i mbisundoj ata armiku përpos që ata të jenë sundimtar të vetvetes së tyre dhe të mos shfarosen përnjëherë. Zoti im më tha: “O Muhamed, Unë kur të caktoj dhe të marr vendim askush nuk mund ta ndryshoj. Unë veç e kam caktuar për umetin tënd mos me u asgjësua, dhe mos me i mposhtë në tërësi asnjëherë armiku, përpos sundimtarë të vetes së

tyre, edhe nëse tubohen kundër tyre gjithçka ka ne glob.” Ose ka thënë: “Çka ka mes lindjes dhe perëndimit derisa ata, armiqtë e tyre do ta shkatërrojnë njëri-tjetrin, ose ta asimilojnë njëri-tjetrin.”

Xhabir bin Semrete transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kjo fe do të qëndroj deri në ditën e kijametit për të cilën do të luftojnë qoftë edhe një grup i vogël i muslimanëve.”

(Sahih Muslim, 3546)

Transmeton Ebi Inbete el Hulani se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:

“Gjithmonë Allahu do të mbjell diçka, e cila jep fryte dhe e shfrytëzojnë për dëgjueshmëri në këtë fe.”

Në një transmetim tjetër thuhet:

“Gjithmonë Allahu do të mbjellë diçka, e cila jep fryte dhe e shfrytëzojnë për dëgjueshmëri në këtë fe deri në ditën e kijametit.”

(Suneni Ibni Maxhes 8. Sahih El Xhamië i Shejh Albanit 7692)

Transmetohet nga Ebi Kabili, i cili ka thënë:
Kemi qenë te Abdullah bin Amr bin Asi dhe e kemi pyetur: Cili qytet do të çlirohet më parë: Konstantinopoli apo Roma? Abdullahu e kërkoi një pako të tij, pastaj prej aty e nxori një libër dhe tha:

*Derisa ne ishim rreth e përqark të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. duke shkruar, kur iu bë një pyetje: Cili qytet do të çlirohet më parë: Konstantinopolisi apo Roma? Ai është përgjigjur: “**Më parë do të çlirohet qyteti i Herakliut.**” Pra ka pas për qëllim Konstantinopolisin.*

(Ahmedi 6358, Darumiji 476)

Kështu veç është çlirua Konstantinopolisi pas 9 shekujve prej duarve të djaloshit të ri musliman, të devotshëm, i cili veç sa i kishte mbushur 23 vjet, dhe është quajtur “Muhamed Fatih”, Muhamedi Çlirimtarë.

Është e sigurt se do të çlirohet edhe Roma, këtë lajm që po e them do të jetë i vërtetë dhe i realizueshëm ka thënë Muhamed bin Abdullah r.a..

Në përfundim veç kanë filluar me të madhe ta pranojnë Islamin, a nuk është përgëzim dhe paralajmërim ky?

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Nuk do të ndodh dita e kijametit derisa mos të luftojnë muslimanët kundër jehudive, dhe muslimanët të fitojnë prej tyre, dhe derisa jehudiu nuk do të ketë vend për t’u fshehur, përpos pas gurëve dhe lisave, ndërsa gurët dhe lisat do të flasin dhe do të thonë: O musliman, o rob të Allahut, jehudiu është fshehur pas neve, eja dhe mbyte, përpos lisit të

quajtur “Garkad” sepse ai lloj lisi është prej llojit të lisit të jehudive.”

(Sahih Muslim, 5203)

Transmeton Abdullah bin Mesudi se pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Po të jetë vetëm një ditë para ditës se kijametit, Allahu do ta zgjatte atë ditë, derisa ta dërgojë një njeri prej meje, ose prej familjes sime, emri i të cilit do të jetë emri im, dhe emri i babës së tij do të jetë emri i babait tim, i cili do ta mbush dynjanë (botën) me drejtësi dhe vërtetësi, ashtu qysh më herët ka qenë e mbushur me krime dhe padrejtësi.”

(Suneni i Ebi Davudit 3733. Sahih Xhamië Albani 5304)

Kjo shpresë është shpresë madhështore dhe në të njëjtën kohë paralajmërim i sigurt për ne.

Pas gjithë kësaj që përmendëm çka nevojitet më shumë për të mbjellë shpresë në zemrën tënde?!

4. Kjo fe çdo herë, që sa më shumë i afrohet rrëzimit aq më shumë forcohet dhe stabilizohet.

T’i analizojmë së bashku ndodhitë e qarta nëpër të cilat kanë kaluar muslimanët prej krizave (vështirësive) dhe kalimin e atyre krizave me lehtësi.

Vdekja e Hadixhës r.a. dhe Ebi Talibit në të njëjtin vit, i cili është quajtur viti i pikëllimit – i krizës

(vështirësisë), menjëherë pas atij viti ndodhi hixhreti, pra tejkalimi i krizës – lehtësimi.

Vdekja e pejgamberit s.a.v.s. dhe renegatimi (dalja prej feje) e fiseve arabe, ka qenë vështirësi , pastaj menjëherë ka ndodhur tejkalimi i vështirësisë me çlirimin e Persisë dhe Romës (Konstantinopolisit) – pra, lehtësimi.

Rënia e shumë mbretërve në Andaluzi – krizë (vështirësi), pastaj paraqitja e shtetit “Murabit”, i cili ka zgjatur 400 vite në Andaluzi – pra lehtësimi.

Okupimi i Mesxhidi Aksasë nga Kryqtarët për një kohë të gjatë (90 vite), pastaj çlirimi i tij prej duarve të Salahudin Ejubit – lehtësimi.

Sulmi i Tatarëve mbi kryeqytetin e Hilafetit Islam, Bagdadit, i cili sulm shkatërroi gjithë civilizimin – krizë dhe vështirësi, pastaj fitorja kundër tyre dhe çlirimi i tij – lehtësim.

Përfundimisht rënia e Andaluzisë – krizë dhe vështirësi, ndërsa në të njëjtën vit çlirimi i Konstantinopolisit – lehtësimi.

Nuk perëndon dielli i islamit në Evropën perëndimore, pa lindur dielli i islamit në lindje të Evropës.

5. Këndellja dhe zgjimi i Islamit

Ky zgjim është prej paralajmërimeve në të forta. Rinia Islame ka filluar për t’i mësuar ligjet dhe dispozitat e fesë së tij, mësimin e rregullave të

texhvidit, për ta adhuruar Allahun me dije dhe argumente, dhe për ta lexuar Kur'anin më përpikëri.

Po ashtu edhe femra në moshën e pjekurisë tubohen dhe mësojnë rregullat e fesë së tyre, dhe rregullat e përpikërisë së leximit të Kur'anit (Texhudit).

Gjithashtu shumë të reja mbulohen, e ruajnë identitetin e tyre, dhe nuk përzihen me meshkuj.

Videokasetat, kasetat, DVD-it me të madhe shumëzohen, shpërndahen, dëgjohen.. Librat me tematikë islame janë prej librave më të kërkuara, shiten, blihen me të madhe, botohen dhe shpërndahen.

Numri i atyre të cilët shkojnë në Umre dhe Haxh vetëm se shtohet me të madhe.

Po ashtu shtohet numri i të rinjve të aftë dhe të suksesshëm, nëpunës dhe punëtorë efektiv, dhe njerëzit më autoritativ janë të devotshëm, dhe i përmbahen fesë, ndërsa dihet kjo luan një rolë shumë të madh.

Njerëzit me renome, filozofët, shkencëtarët etj., etj., të perëndimit e pranojnë Islamin.

6. Perëndimorët me të madhe e pranojnë Islamin

Kjo çështje është prej përgëzimeve dhe paralajmërimeve, e cila ka vlerë të madhe dhe jep shpresë të madhe.

7. Shtimi i femrave të cilat i përkushtohen dhe i përmbahen rregullave islame dhe largimi i tyre prej mëkateve.

Gjithashtu edhe kjo është çështje prej përgëzimeve dhe paralajmërimeve të sigurta, sepse femra përbën 50% të shoqërisë, ajo e edukon 50% - shin e shoqërisë.

8. Umeti posedon resurse të shumta të fortësisë Nuk ka dyshim se umeti islam posedon forcë të madhe, posedon forcën e madhe shpirtërore, shumë ndikuese dhe shumë reflektuese, posedon numër të madh dhe absolut të anëtarëve, posedon fuqinë materiale, dhe ekonomike të shumta, posedon armën e fortë, dhe programin stabil, të cilin nëse e vë në praktik askush nuk mund t'i dal përpara, do të ndryshoj gjendja për së tepërmi pozitivisht, ajo armë është arma e përjetësimit me ligjin e planprogramit madhështorë të Allahut.

“Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ta ndryshojnë ata gjendjen e tyre.”

(Erraëd, 11)

9. Dështimi i të gjitha sistemeve dhe ideologjive të tjera (të të tjerëve) dhe rrëzimi i tyre

Sikurse Allahu i Lartmadhëruar na thotë: I keni provuar të gjitha ideologjitë, të gjitha sistemet tjera, mirëpo u vërtetua se ato janë të caktuara për dështim, për këtë arsye nuk ka mbetur tjetër përpos që me iu përmbajt apo me iu rikthye Islamit, si fe, program, sistem dhe ligj të jetës.

E kemi provuar komunizmin, kapitalizmin, laicizmin, etj., etj., prej ideologjive dhe sistemeve shkatërruese, edhe për këtë arsye kemi dështuar dhe jemi ndeshur mu me atë, të cilit i kemi besuar më së shumti.

Për ju nuk ka tjetër, pos Islamit, si fe, sistem dhe ligj të jetës, nëse dëshironi forcën, nderin, reputacionin, ngritjen, sigurinë, qetësinë dhe lumturinë, edhe në këtë botë edhe në botën tjetër.

10. Pas çdo vështirësie vjen lehtësimi, triumfi pas durimit dhe drita pas errësirës. Kohët dhe e epokat e gjata me errësirën e natës pasohen me dritën e lindjes së diellit menjëherë.

Në momentet e fundit kur është errësira maksimale, ngushtimi më i madh, vështirësia më e madhe, vjen çlirimi dhe lehtësia.

Transmeton Ibn Abasi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Ta dish se prej durimit, të cilin edhe pse nuk e ke pëlqyer, ke të mira të shumta dhe fitorja arrihet me durim, fati pas fatkeqësisë, lehtësimi pas vështirësisë.”

U ngushtua rrethi sa që të gjitha hallkat ishin të ndërlidhura fort.

Mirëpo u çlirua dhe u ç'thuren derisa unë mendoja se nuk do të çlirohen.

Mbani mend këto paralajmërime, shënoni dhe regjistroni, përhapni dhe mbillni këto përgëzime, dhe paralajmërime, shpresën në zemrat, dhe shpirtrat tuaja.

* * *

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori *Muhamed Sajim*);
2. “Islami dhe Politika” (nga autori *Jusuf Kardavi*);
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori *Abdurrezak Nufel*);
4. “Për Kushtetutën Islame” (nga autori *Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer*);
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori *Abduhu Abas El-Velidi*)
6. “Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët *Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir*).
7. “101 Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë”
8. “Fetavatë e Shaëravijut”
9. “Vlera e kohës” (nga autori *Amër Halid*);
10. “Vëllazëria muslimane” (nga autori *Amër Halid*);
11. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori *Amër Halid*);
12. “Pendimi” (nga autori *Amër Halid*);
13. “Pasojat e mëkateve” (nga autori *Amër Halid*);
14. “Vendosmëria në rrugën e Allahut (nga *Amër Halid*);

15. *“Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut nga autori Amër Halid);*
16. *“Superfuqia në Allahun” nga autori Amër Halid);*
17. *“Bindja e thellë në Allahu” nga autori Amër Halid);*
18. *“Shpresa në Allahun” nga autori Amër Halid);*
19. *“Shpresa duhet të jetë besim dhe veprim” nga autori Amër Halid);*
20. *“Pozitiviteti” nga autori Amër Halid);*
21. *“Serioziteti”.*

PËRMBAJTJA

SHPRESA NË ALLAHUN	3
RREZIKU I PESIMIZMIT DHE HUMBJES SË SHPRESËS	5
SHPRESA DHE AMBICIA	8
PËRGËZIMET, PARALAJMËRIMET, DHE NXITJE PËR SHPRESË, DHE BESIM NË ALLAHUN E LARTMADHËRUAR	11
KY UMET NUK ZHDUKET DHE NUK DËSHTON TËRËSISHT ASNJËHERË	13
AJETET KUR'ANORE DHE HADITHET E MUHAMEDIT A.S.	15
LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)	26
PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE	27